28 NËNTORI, DITA E BASHKIMIT TË POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR ZAPTUESIT FASHIST

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

Nëntor 1942

Si më 28 Nëntor 1912, kur në Vlorën heroike ishin mbledhur nga të katër anët e Shqipërisë delegatët për me shfaqë vullnetin e popullit tonë, ashtu edhe më 28 Nëntor 1942 populli shqiptar, në gjithë qytetet e Shqipërisë, kishte dalë nëpër rrugë për me luftue për liri, kishte dalë në rrugë i madh e i vogël, plak e i ri, gra e çupa, myslimanë e të krishterë; kishte dalë në rrugë, si një bllok, kundër zaptuesit dhe hyzmeqarëve të tij të urryer. Popull kreshnik shqiptar, ti je i pathyeshëm, i patrembur. Mbi ty kanë kapërcyer valët e tmerrshme të robërisë, ty të kanë lidhur prangat e zgjedhës së huaj, por ti, si dragua, i ke këputur, i ke bërë thërrime e pluhur, ke çuar kryet madhështor, i gjakosur por i lirë, i lirë si ajri i maleve tona. Në momentet kritike të jetës tënde, në momentet kur rreziku po i turrej atdheut, popull shqiptar, ti forcove radhët e tua, ti shtrëngove supet, ti çelikose zemrat, dhe kraharorët e tu u bënë mburoja e atdheut.

Si më 28 Nëntor 1912, ashtu edhe më 28 Nëntor 1942, në gjithë rrugët e Shqipërisë, në malet e Shqipërisë, në fushat e Shqipërisë, gjëmoi kushtrimi «Ja vdekje, ja liri!», dhe më 28 Nëntor 1942 flamurin e Skënderbeut e ngriti lart populli i Shqipërisë, e ngritën nëpër male e fusha luanët antifashistë, që po luftojnë me pushkë në dorë fashizmin dhe tradhtarët, e ngritën dëshmorët e lirisë. Më 28 Nëntor zemrat e popullit tonë rrahën së bashku për një qëllim: vdekje fashizmit dhe liri popullit.

Fashizmi me hyzmeqarët e tij u drodhën këtë ditë, u drodhën nga forca e popullit tonë.

Fashizmi me hyzmeqarët e tij u përpoqën që të rrenin popullin, ata u përpoqën ta përvetësonin ditën e lirisë, ata u përpoqën të përdornin demagogjinë e tyre të zakonshme, por populli i demaskoi, populli fërshëlleu ushtrinë e Duçes dhe zagarët e Merlikës, populli brohoriti ushtarët shqiptarë dhe, në fytyrë të Merlikës e të Jakomonit, ai u thirri ushtarëve shqiptarë të dezertonin në male dhe të luftonin me pushkë kundër zaptuesit.

Në strofkën e tyre të kusarëve Jakomonët e Merlikët dridhen, sepse Shqipëria mbarë buçet:

«POSHTË FASHIZMI, POSHTË TRADHTARËT, POSHTË KOLONA E PESTË!», «RROFSHIN ALEATËT TANË TË MËDHENJ: ANGLIA – BASHKIMI SOVJETIK – AMERIKA!», «RROFSHIN ÇETAT VULLNETARE E PARTIZANE, RROFTË LUFTA NACIONALÇLIRIMTARE, RROFTË KËSHILLI I PËRGJITHSHËM NACIONALÇLIRIMTAR, RROFTË SHQIPËRIA E LIRË DHE DEMOKRATIKE!».

Në strofkën e tyre të kusarëve Jakomonët dhe Merlikët dridhen, se malet e Shqipërisë po buçasin nga krisma e pushkëve të partizanëve dhe vullnetarëve. Jakomonët e Merlikët dridhen, se gjëmon Zagoria, gjëmon Kurveleshi, gjëmon Vlora e Selam Musait, gjëmon Korça e Gërmenjit, e Bajazit Rehovës, gjëmon Skrapari i Riza Cerovës, gjëmon Elbasani i Kristoforidhit, gjëmon Tirana e Hasan Voglit, gjëmojnë rrethet e Pezës e të Krujës, gjëmojnë Shkodra dhe Dibra, gjëmon gjithë Shqipëria.

Në strofkën e tyre të kusarëve Jakomonët, Merlikët dhe kolona e pestë dridhen, se e shohin me tmerr që orvatjet e tyre vanë kot, se intrigat e tyre për të përçarë popullin tonë dështuan.

Populli shqiptar, më i bashkuar se kurrë, e ka kuptuar se liria fitohet me sakrifica e me gjak; populli shqiptar ditën e 28 Nëntorit u betua se do të luftojë si një trup fashizmin zaptues dhe kryehyzmeqarët e tij; populli shqiptar, i bashkuar rreth Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, po hidhet i tëri në Luftën Nacionalçlirimtare dhe bën fli çdo gjë të tijën për luftën që do t'i sjellë lirinë e sigurt e të vërtetë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 8-9, nëntor 1942

Botohet sipas: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1. Tiranë, 1968